

L I G J

Nr. 8270, DATE 23.12.1997

PER KONTROLLIN E LARTE TE SHETITIT

Në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991
"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupin
deputetësh të Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe
Privatizimit

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka të bëjë me objektivat, detyrat, organizimin dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë (më poshtë Kontrolli i Lartë i Shtetit).

K Kontrolli i Lartë i Shtetit është një organ i depolitizuar dhe i departizuar.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit është një organizëm i pavarur kontrolli i Republikës së Shqipërisë.

Në ushtrimin e kompetencave të tij ai i nënshtrohet vetëm kushtetutës dhe ligjit.

Neni 2

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare të kontrollit të përpunuar nga INTOSAI, kontrollon administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në subjektet e përcaktuara me këtë ligj.

K Kontrolli mbulon çështjet e rregullshmërisë, të administrimit financiar dhe vlerësues.

Neni 3

Mjetet financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit përballohen nga buxheti i shtetit, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një kapitull të veçantë.

Projektbuxheti propozohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, i cili e paraqet për miratim në Kuvendin Popullor në përputhje me ligjin për buxhetin.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet çdo vit të përgatisë llogaritë e tij në përputhje me ligjin për buxhetin. Llogaritë e tij kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi Popullor dhe raporton te ky.

Neni 4

Kontrolli i Lartë i Shtetit kooperon me institucionet e larta të kontrollit dhe organizatat profesionale ndërkombëtare dhe rajonale në formë të përshtatshme për kontrollin.

Neni 5

Konfliktet e kompetencave midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore (publike) zgjidhen nga gjykata e apelit në përputhje me procedurat e saj.

KREU II

OBJEKTIVAT

Neni 6

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka si objekt kryesor kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e miradministrimit financiar, si dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare.

Objekt kryesor është, gjithashtu, të komunikojë dhe t'i japë informacion autoriteteve publike, si dhe publikut në përgjithësi, nëpërmjet publikimit të raporteve të paanshme. Subjektet e kontrolluara duhet të kenë gjithnjë mundësinë që të bëjnë vërejtje për projekt raportin e kontrollit para publikimit të tij. Vërejtjet e bëra duhet të pasqyrohen në raportet përfundimtare.

KREU III

DETYRAT

Neni 7

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me kompetencat e tij, të përcaktuara në këtë ligj, duhet të kryejë kontroll për ligjshmërinë, rregullshmërinë, financiar dhe vlerësues në fushat dhe subjektet e mëposhtme:

- në organet e larta të pushtetit shtetëror (Kuvendi Popullor, Presidencë) dhe të administratës shtetërore (aparatin e Këshillit të Ministrave, ministrinë dhe institucionet qëndrore);
- në organet e pushtetit lokal;
- në institucionet buxhetore;
- në shoqëritë tregtare ku shteti ka një ndikim kontrolluese si rrjedhojë e shumicës së aksioneve ose marrëveshjeve;
- në organizmat jofitimprurës dhe subjektet private, ku shteti ka një ndikim kontrolluese si pasojë e shumicës së aksioneve, të marrëveshjeve ose për shkak se ato marrin subvencione nga shteti ose fonde me financime të huaja që i janë dhënë Qeverisë Shqiptare;
- forcat e armatosura, si dhe të sigurimit kombëtar;
- partitë politike dhe organizatat, për fondet që u janë dhënë atyre nga buxheti i shtetit;

- programet qeveritare, projektet dhe aktivitetet me financime të huaja;
- Banka e Shqipërisë si dhe bankat e tjera shtetërore të nivelit të dytë, ku shteti ka një ndikim kontrollues për shkak të shumicës së aksioneve ose të marrëveshjeve;
- institutet kombëtare të sigurimeve si dhe institucionet e tjera financiare, ku shteti ka një ndikim kontrollues për shkak të shumicës së aksioneve ose të marrëveshjes;
- në organet e kontrollrevizionit të brendshëm (shtetëror);
- subjektet e tjera të përcaktuara në ligje të veçanta.

Neni 8

Kontrolli i Lartë i Shtetit boton rregullisht një buletin. Ky buletin duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:

- raportet vjetore
- konkluzionet e kontrollit të një rëndësie të veçantë
- rregullat dhe procedurat e Kontrollit të Lartë të Shtetit
- llogaritë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfshirë edhe opinionin e kontrollorëve për to.

Neni 9

Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të japë rekomandime përse i përket kontrollit të drejtimit dhe të kontroll revizionit të brendshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit jep opinionet e tij, si dhe bën propozime përse i përket përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit në fushat brenda detyrave të tij.

Nëse Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë kontrollit konstaton akte ligjore ose nënligjore në kundërshtim me ligjet bazë, atëherë ai mund të kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e tyre nga organet që i kanë nxjerrë. Nëse ky i fundit nuk e ndryshon ose shfuqizon aktin ligjor ose nënligjor brenda 2 muajve nga data e kërkuar, atëherë Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet t'u drejtohet organeve kompetente të përcaktuara në ligj.

KREU IV

ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE KOMPETENCAT

Neni 10

Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka qendrën në Tiranë. Ai vendos për departamentet e veta rajonale, të cilat janë të varura nga qendra.

Departamentet drejtohen nga drejtorët. Drejtorët e departamenteve caktohen nga kryetari.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vulën e tij që paraqet stemën shtetërore të Republikës së Shqipërisë, që përmban emrin e tij.

Neni 11

Kontrolli i Lartë i Shtetit drejtohet nga kryetari. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryesinë e tij, e cila përbëhet nga tre persona: Kryetari, zëvendëskryetari i parë dhe zëvendëskryetari i dytë. Kryetari dhe zëvendëskryetarët zgjidhen me propozim të Presidentit të Republikës nga Kuvendi Popullor me shumicë absolute për një mandat

shtatë vjeçar, por jo më shumë se dy herë radhazi. Vetëm për mandatin e parë të zgjedhjes, zëvendëskryetari i parë zgjidhet për një mandat pesë vjeçar dhe zëvendëskryetari i dytë për një mandat tre vjeçar.

Anëtarët e Kryesisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të jenë të diplomuar me arësim të lartë në financë, në ekonomi ose jurisprudencë dhe të kenë jo më pak se 10 vjet përvojë pune në profesionin e tyre. Ata duhet të jenë persona të respektuar dhe të mos kenë qenë dënuar për ndonjë krim, me përjashtim të atij politik.

Vendimet nga ana e Kryesisë merren me shumicë votash. Kryesia merr vendime kur janë të pranishëm jo më pak se 2 anëtarë të saj.

Votimi është i hapur.

Paga e kryetarit të Kontrollit të Shtetit është e barabartë me atë të kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe paga e zëvendës kryetarëve të Kontrollit të Lartë të Shtetit është e barabartë me atë të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Kasacionit, e cila korrigjohet herëpashërë sipas indeksimit të pagave që bën Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Kryesia e Kontrollit të Lartë të Shtetit merr vendime për:

- rregullat dhe procedurat e kryesisë;
- kompetencat dhe detyrat e drejtorëve;
- rregullat në përputhje me ligjet për emërimin dhe largimin e personelit;
- planin vjetor të kontrollit;
- standardet e kontrollit;
- raportin vjetor të kontrollit;
- të bërë propozime të Kryetari për masat disiplinore ndaj punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- buletin;
- materialet të cilat u dërgohen Prokurorisë për ndjekje penale;
- çështjet të cilat do të dërgohen në gjykatë;
- çështje të tjera që Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ose Kryesia i gjykon të nevojshme ose që janë të specifikuar në ligj.

Vendimet për të gjitha çështjet e tjera, që nuk përmenden më lart, merren nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ose personat e autorizuar prej tij. Nëse kryetari nuk është në institucion për ndonjë arsye, funksionet e tij kryhen nga zëvendëskryetari i parë dhe në mungesë të këtij të fundit, nga zëvendëskryetari i dytë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në marrëdhëniet me të tjerët përfaqësohet nga kryetari i tij ose nga ndonjë person i autorizuar prej tij.

Drejtorët e departamenteve raportojnë te kryetari dhe Kryesia.

Neni 13

Detyra e Kryetarit, e dy zëvendëskryetarëve, e drejtorëve të departamenteve dhe e kontrollorëve në qendër dhe në rajone është e papajtueshme me:

- kryerjen e detyrave me ose pa shpërblim në subjektet publike, private dhe jofitimprurëse me përjashtim të mësimdhënies, të drejtës së autorit dhe veprimtarive kulturore;
- mandatin e deputetit;
- të qenurit anëtar i Qeverisë ose i ndonjë partie ose organizate politike;
- marrëdhëniet fafeshnore deri në dy breza midis kryetarit dhe zëvendëskryetarëve.

Para marrjes së detyrës, anëtarët e Kryesisë betohen përpara Kuvendit Popullor. Drejtorët betohen përpara Kryesisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Kryesia.

Neni 14

Mandati i anëtarëve të Kryesisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit përfundon para afatit vetëm për shkak:

- të heqjes dorë nga detyra;
- të dënimit me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
- të ngarkimit me një detyrë të papajtueshme;
- të gjendjes shëndetësore që e bën të pamundur përmbushjen e detyrës;
- të vdekjes.

Anëtarët e Kryesisë gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, ndalohen ose arrestohen pa pëlqimin e Kuvendit Popullor.

Neni 15

K Kontrolli i Lartë i Shtetit kontraktin ekspertë të përkohshëm. Ekspertët që janë kontraktuar kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si dhe kontrollorët e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 16

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë:

- të kërkojë nga subjektet e kontrolluara marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes në përputhje me rekomandimet e kontrollit;
- të kërkojë nga subjektet e kontrolluara ose nga autoritetet më të larta shtetërore marrjen e masave të zhdëmtimit dhe disiplinore në përputhje me ligjet përkatëse ndaj personave që kanë shkaktuar dëme direkte ose indirekte;
- të njoftohet për kërkesat e bëra, sipas paragrafit të mësipërm, nga subjektet e kontrolluara brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;
- të marrë masa në përputhje me rregullat për prokurimet, kur janë shkelur procedurat e prokurimeve;
- të bëjë padi në gjyq.

KREU V E DREJTA E DISPONIMIT TE DOKUMENTEVE DHE E INFORMACIONIT

Neni 17

I gjithë dokumentacioni, që Kontrolli i Lartë i Shtetit e gjykon të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, duhet t'u sigurohet dhe t'u paraqitet nga subjektet e kontrolluara përfaqësuesve të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kur është e nevojshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë:

- a) të pyesë me shkrim ose verbalisht subjektet e kontrolluara ose punonjësit e tyre, të cilët janë të detyruar t'i përgjigjen me shkrim ose verbalisht sipas kërkesës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda një jave nga kërkesa e bërë;

b) të kërkojë nga subjektet e kontrolluara t'i sigurohen menjëherë ambientet dhe pajisjet e punës në përputhje me këtë ligj;

c) të kërkojë nga subjektet e kontrolluara në nenin 6 të këtij ligji t'i vihet në dispozicion brenda një jave gjithë dokumentacioni për vlerat materiale e financiare, si dhe dokumentacioni për veprimtarinë ekonomike dhe financiare;

d) të kërkojë nga Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë e bankat e tjera të përbashkëta t'i vihen në dispozicion brenda një jave të dhënat për llogaritë e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit në bazë të këtij ligji.

Gjatë kontrollit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas nenit 6 paragrafi 2, dërgon raportin e kontrollit të subjektet e kontrolluara. Këta të fundit janë të detyruar të japin shpjegimet e tyre brenda një muaji.

KREU VI RAPORTET E KONTROLLIT

Neni 18

Kryesia e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet t'i paraqesë Kuvendit Popullor një raport vjetor me opinionin e tij për buxhetin faktik të shtetit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë konkluzionet e kontrollit. Ky raport duhet të përfshijë, gjithashtu, zbatimin e detyrave të lëna nga subjektet e kontrolluara sipas rekomandimeve të kontrollit.

Raporti vjetor duhet të paraqitet në Kuvendin Popullor në përputhje me ligjin për Buxhetin. Raporti vjetor publikohet në buletin.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton në Kuvendin Popullor.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit informon Kuvendin Popullor në çdo kohë për çështje që Kryesia i gjykon me interes.

Kryetarit të Kontrollit të Shtetit, me kërkesën e tij, i jepet fjala për çështjet brenda kompetencave të Kontrollit të Lartë të Shtetit në sesionet e punës të Kuvendit Popullor dhe të komisioneve të përhershme të tij.

Ai mund të dërgojë përfaqësuesit e tij në takimet me subjektet e kontrolluara, kur diskutohen raporte kontrolli të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 19

Kryesia duhet t'i paraqesë Këshillit të Ministrave dhe autoriteteve të tjera, kur ajo e gjykon të nevojshme dhe në interes të shtetit dhe të publikut, raporte, studime dhe materiale të tjera që kanë të bëjnë me Këshillin e Ministrave, ministrinë dhe institucionet qendrore.

KREU VII STATUSI I PERSONELIT DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 20

K Kontrolli i Lartë i Shtetit cakton personelin e nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të tij. Kualifikimi dhe kriteret e tjera për personelin, në të gjitha nivelet, përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Kryesia. Kjo rregullore botohet në buletin.

Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Kryesia.

Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk lejohet të jenë deputetë, anëtarë të partive dhe të organizatave politike, si dhe nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike ose me karakter tregëtar.

Pagat dhe kushtet e veprimtarisë së punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Kryesia konform kriterëve ligjore.

Shkaqet për të cilat një punonjës mund të largohet nga puna përcaktohen në rregulloren e miratuar nga kryesia, bazuar në legjislacionin e punës.

Për shkeljet e bëra gjatë kohës së ushtrimit të detyrave të tyre si dhe të shkeljes së këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, kundrejt punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit merren masat e mëposhtme disiplinore:

1. vërejtje
2. vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra
3. transferim nga një departament në qendër në një rajon
4. largim nga detyra

Masat e mësipërme merren nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KREU VIII

ANKIMI

Neni 21

Ankimi kundrejt vendimit të kryetarit për largimin nga puna bëhet në gjykatë brenda 10 ditëve nga marrja njoftim.

KREU IX

RUAJTJA E SEKRETTIT

Neni 22

Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet t'i kushtojë kujdesin e duhur sekretit shtetëror e tregëtar.

Kontrollorët e Kontrollit të Lartë të Shtetit pajisen me kartën e identifikimit personal të lëshuar nga kryetari i tij.

Standardet e kontrollit të nxjerra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe nga organet e kontroll-revizionit të brendshëm (shtetëror).

Neni 23

Veprimtaritë që përbëjnë sekret shtetëror bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, duhet të kontrollohen nga kontrollorët e autorizuar nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe raportimi i zbulimeve të kontrollit duhet të bëhet prej tij në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit të Kuvendit Popullor.

KREU X
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 24

Ligji nr.7597, datë 31.8.1992 "Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit" ndryshuar me ligjin nr.7949, datë 14.6.1995 dhe me ligjin nr.8236, datë 28.8.1997, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Ligji nr.7802, datë 2.3.1994 "Për pagat e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit" ndryshuar me ligjin nr.8037, datë 22.11.1995, shfuqizohet.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi me 15 janar 1998.

L I G J

Nr.8599, datë 01.06.2000

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8270, DATË 23.12.1997 "PËR KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT"

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1, 162-165 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

- Në nenin 1, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar në Republikën e Shqipërisë".
Në paragrafin e dytë hiqen fjalët: "Kontrolli Lartë i Shtetit është një organizëm i pavarur kontrolli i Republikës së Shqipërisë".

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:
"Konfliktet e kompetencave midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore (publike) zgjidhen nga Gjykata Kushtetuese."

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si vijon:
"Kontrolli i Lartë i Shtetit në përputhje me kompetencat e tij kontrollon:
a) veprimtarinë ekonomike e financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor;
c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;
ç) përdorimin e fondeve që u janë dhënë nga Buxheti i Shtetit partive politike dhe shoqatave;
d) mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll-revizionit të brendshëm shtetëror;
dh) subjektet e tjera të përcaktuara me ligje të veçanta."

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Kontrolli i Lartë i Shtetit drejtohet nga Kryetari.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rrizgjedhjeje.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhe të jetë shtetas shqiptar me arsim të lartë në ekonomi, në financë ose juridik dhe të ketë jo më pak se 10 vjet punë në profesion, të gëzojë një figurë të pastër etiko-morale dhe të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë.

Paga e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë."

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit vendos për:

- a) strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të shtetit;
- b) kompetencat dhe detyrat e drejtorëve dhe njërive organizative;
- c) strukturën e pagës dhe shpërblimin e personelit;
- ç) planin vjetor të kontrollit;
- d) standardet e kontrollit;
- dh) buletin;
- e) materiale të cilat i dërgohen prokurorisë për ndjekje penale;
- ë) çështje të cilat do t'i dërgohen gjykatës;
- f) çështje të tjera që i gjykon të nevojshme ose që janë të specifikuar në ligje.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në marrëdhënie me të tjerët, përfaqësohet nga Kryetari dhe në mungesë nga një person i ngarkuar prej tij."

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë, rreshti i parë, hiqen fjalët "e dy zëvendëskryetarëve".

- Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

"Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit fillon detyrën pasi bën betimin përpara Kuvendit.

Formula e betimit është: "Beto hem se gjatë kryerjes së detyrave të mia do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ligjit"."

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbaron para afatit kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- c) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se gjashtë muaj rresht;
- ç) deklarohet i paafte mendërisht për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) ngarkohet me një detyrë të papajtueshme me funksionin e tij.

Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ndalohej ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi, ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

Me propozimin e Presidentit të Republikës, Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij mund ta shkarkojë Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike dhe për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra."

Neni 8

Neni 18 ndryshohet si vijon

"Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:

a) raportin për zbatimin e buxhetit faktik të shtetit, duke përfshirë konkluzionet e kontrollit me opinionin e vet. Raporti vjetor paraqitet në Kuvend në përputhje me ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".

Raporti vjetor publikohet në buletin;

b) mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, para se të miratohet në Kuvend;

c) informacion për rezultatet e kontrollit, sa herë që kërkohen nga Kuvendi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund t'i kërkojë Kuvendit që të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme."

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

- Në rreshtin e parë, fjala "Kryesia" zëvendësohet me fjalët "Kontrolli i Lartë i Shtetit".

- Në fillim të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shtrohen çështje që lidhen me funksionet e tij."

Neni 10

Neni 20 ndryshohet si vijon:

"Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të bëjnë pjesë në asnjë organizatë ose parti politike, si dhe nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike ose me karakter tregtar.

Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë profesionale në përputhje me standardet e kontrollit dhe normat etike.

Administrimi i shërbimit civil në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ngritja në detyrë, lëvizja paralele, vlerësimi, transferimi, lirimi, pezullimi, si dhe masat disiplinore bëhen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Neni 11

KREU VIII, ANKIMI, neni 21 shfuqizohet.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

(botuar ne Fletoren Zyrtare nr.15 te vitit 2000 , doli nga shtypi me 21.06.2000)

VENDIMI NR.212 DATE 29.10.2002
I GJYKATES KUSHTETUESE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Shpall te papajtueshme me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise paragrafin e pare dhe te kater te nenit 14 te ligjit nr.8270 date 23.12.1997 "Per Kontrollin e Larte te Shteti" ndryshuar me ligjin nr. 8599 date 01.06.2000 "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin per Kontrollin e Larte te Shtetit".

(pjesa e dispozites se nenit 14 te ligjit e shpallura te papajtueshme me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise)

"Mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbaron para afatit kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- c) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se gjashtë muaj rresht;
- ç) deklarohet i paaftë mendërisht për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d) ngarkohet me një detyrë të papajtueshme me funksionin e tij.

Me propozimin e Presidentit të Republikës, Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij mund ta shkarkojë Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike dhe për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra."

REPUBLIKA E SHQIPERISE
K U V E N D I

LIGJI

Nr 8270 , date 23.12.1997

PER
KONTROLLIN E LARTE TE SHTETIT

(Ndryshuar me ligjin Nr 8599 , date 1.06.2000
"Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin Nr 8270, date 23.12.1997 "Per Kontrollin e
Larte te Shtetit")

Ne mbeshtetje te neneve 8, 83 pika 1, 162, 163, 164 dhe 165 te Kushtetutes, me propozimin e nje grupi deputetesh,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Ky ligj ka te beje me objektivat, detyrat, organizimin dhe kompetencat e Kontrollit te Larte te Shtetit te Republikes se Shqiperise (me poshte Kontrolli i Larte i Shtetit).

K Kontrolli i Larte i Shtetit eshte institucioni me i larte i kontrollit ekonomiko financiar ne Republiken e Shqiperise.

K Kontrolli i Larte i Shtetit eshte nje organ i depolitizuar dhe i departizuar.

Ne ushtrimin e kompetencave te tij ai i neneshtrohet vetem kushtetutes dhe ligjit.

Neni 2

K Kontrolli i Larte i Shtetit, ne perputhje me legjislacionin dhe standartet nderkombetare te kontrollit te perpunuar nga INTOSAI kontrollon administrimin e prones shteterore dhe zbatimin e buxhetit te shtetit ne subjektet e percaktuara me kete ligj.

K Kontrolli mbulon ceshtjet e rregullshmerise, te administrimit financiar dhe vleresues.

Neni 3

Mjetet financiare te Kontrollit te Larte te Shtetit perballohen nga buxheti i shtetit, ku Kontrolli i Larte i Shtetit ka nje kapitull te veçante.

Projektbuxheti propozohet nga Kontrolli i Larte i Shtetit ne Komisionin e Perhershem te Ekonomise, Financave dhe Privatizimit, i cili e paraqet per miratim ne Kuvend ne perputhje me ligjin per buxhetin.

K Kontrolli i Larte i Shtetit duhet çdo vit te pergatise llogarite e tij ne perputhje me ligjin per buxhetin. Llogarite e tij kontrollohen nga nje organizem i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe raporton te ky.

Neni 4

K Kontrolli i Larte i Shtetit kooperon me institucionet e larta te kontrollit dhe organizatat profesionale nderkombetare dhe rajonale ne forme te pershtateshme per kontrollin.

Neni 5

Konfliktet e kompetencave midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore (publike) zgjidhen nga Gjykata e Apelit.

KREU II

OBJEKTIVAT

Neni 6

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka si objekt kryesor kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e miradministrimit financiar, si dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmerisë në fushën ekonomike e financiare.

Objekt kryesor është, gjithashtu, të komunikojë dhe t'i japë informacion autoriteteve publike, si dhe publikut në përgjithësi, nëpërmjet publikimit të raporteve të paanshme. Subjektet e kontrolluara duhet të kenë gjithnjë mundësinë që të bëjnë vërtetje për projekt raportin e kontrollit para publikimit të tij. Vërtetjet e bera duhet të pasqyrohen në raportet përfundimtare.

KREU III

DETYRAT

Neni 7

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me kompetencat e tij kontron:

a-veprimtarinë ekonomike e financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridike shtetërore;

b-përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor;

c-veprimtarinë ekonomike të personave juridike, në të cilët shteti ka me shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kredite dhe detyrimet e tyre garantojnë nga shteti;

d-përdorimin e fondeve që u janë dhënë nga Buxheti i Shtetit partive politike dhe shoqatave .

e-mbyqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontrollit revizionit të brendshëm shtetëror;

f-subjektet e tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.

Neni 8

K Kontrolli i Lartë i Shtetit boton rregullisht një buletin. Ky buletin duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:

-raportet vjetore

-konkluzionet e kontrollit të një rendësie të veçantë

-rregullat dhe procedurat e Kontrollit të Lartë të Shtetit

-llogaritë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfshirë edhe opinionin e kontrollorëve për to.

Neni 9

Kontrolli i Larte i Shtetit mund te jape rekomandime persa i perket kontrollit te drejtimit dhe te kontroll revizionit te brendshem.

Kontrolli i Larte i Shtetit jep opinionet e tij, si dhe ben propozime persa i perket permiresimit te metejshem te legjislacionit ne fushat brenda detyrave te tij.

Nese Kontrolli i Larte i Shtetit gjate kontrollit konstaton akte ligjore ose nenligjore ne kundershtim me ligjet baze, atehere mund te kerkoje ndryshimin ose shfuqizimin e tyre nga organet qe i kane nxjerre. Nese ky i fundit nuk e ndryshon ose e shfuqizon aktin ligjor ose nenligjor brenda 2 muajve nga data e kerkuar, atehere Kontrolli i Larte i Shtetit duhet t'u drejtohet organeve kompetente te percaktuara ne ligj.

KREU IV

ORGANIZIMI , STRUKTURA DHE KOMPETENCAT

Neni 10

Kontrolli i Larte i Shtetit ka qendren ne Tirane.

Ai vendos per departamentet e veta rajonale, te cilat jane te varura nga qendra.

Departamentet drejtohen nga drejtoret. Drejtoret e departamenteve caktohen nga kryetari.

Kontrolli i Larte i Shtetit ka vulen e tij qe paraqet stemen shteterore te Republikes se Shqiperise, qe permban emrin e tij.

Neni 11

Kontrolli i Larte i Shtetit drejtohet nga Kryetari.

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit, zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozimin e Presidentit te Republikes. Ai qendron ne detyre 7 vjet, me te drejte rizgjedhje.

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit duhet te jete shtetas shqiptar, me arsim te larte ne ekonomi, ne finance ose juridik dhe te kete jo me pak se 10 vjet pune ne profesion, te gezoje nje figure te paster etiko-morale dhe te mos jete i denuar me vendim gjykate te formes se prere.

Paga e Kryetarit te Kontrollit te Larte te Shtetit eshte e barabarte me pagen e Kryetarit te Gjykates se Larte.

Neni 12

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit vendos per :

a-strukturen, organiken dhe emertimin e funksioneve te Kontrollit te Larte te Shtetit;

b-kompetencat dhe detyrat e drejtoreve dhe njesive organizative;

c-strukturen e pages dhe shperblimin e personelit;

d-planin vjetor te kontrollit;

e-standartet e kontrollit;
f-buletinin;
g-materiale te cilat i dergohen Prokurorise per ndjekje penale;
h-çeshtjet te cilat do ti dergohen Gjykates;
i-çeshtje te tjera qe i gjykon te nevojshme ose qe jane te specifikuara ne ligj.
Kontrolli i Larte i Shtetit, ne maredhenje me te tjeret perfaqesohet nga Kryetari dhe ne mungese nga nje person i ngarkuar prej tij.

Neni 13

Detyra e Kryetarit, e drejtoreve te departamenteve dhe e kontrolloreve ne qender dhe ne rajone eshte e papajtueshme me :

-kryerjen e detyrave me ose pa shperblim ne subjektet publike, private dhe jofitimprurese me perjashtim te mesimdhenjes, te drejtes se autorit dhe veprimtarise kulturore;

-mandatin e deputetit;

-te qenurit anetar i Qeverise ose i ndonje partie ose organizate politike;

-maredhenjet farefisnore deri ne dy breza midis kryetarit dhe zevendeskryetareve.

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit fillon detyren pasi ben betimin perpara Kuvendit.

Formula e betimit eshte: "Betohem se gjate kryerjes se detyrave te mia do t'i qendroj kurdohere besnik Kushtetutes se Republikes te Shqiperise dhe ligjit".

Neni 14

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit te Gjykates se Larte.

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit mund te ndalohet ose arrestohet vetem ne qofte se kapet ne kryerje e siper te nje krimi ose menjehere pas kryerjes se tij. Organi kompetent njofton menjehere Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pelqimin brenda 24 oreve per dergimin ne gjykate te Kryetarit te Kontrollit te Larte te Shtetit, organi kompetent eshte i detyruar ta liroje ate.

Neni 15

Kontrolli i Larte i Shtetit kontraktton eksperte te perkohshem. Ekspertet qe jane kontraktuar kane te njejtat te drejta dhe pergjegjesi se edhe kontrolloret e Kontrollit te Larte te Shtetit.

Neni 16

Kontrolli i Larte i Shtetit ka te drejte :

-te kerkoje nga subjektet e kontrolluara marjen e masave te nevojshme per permiresimin e gjendjes ne perputhje me rekomandimet e kontrollit;

-te kerkoje nga subjektet e kontrolluara ose nga autoritetet me te larta shtetore marjen e masave te zhdemtimit dhe disiplinore ne perputhje me ligjet perkatese ndaj personave qe kane shkaktuar deme direkte ose indirekte;

-te njoftohet per kerkesat e bera sipas paragrafit te mesiperm, nga subjektet e kontrolluara brenda 20 diteve nga data e marjes se kerkeses;

-te marre masa ne perputhje me rregullat per prokurimet, kur jane shkelur procedurat e prokurimeve;

-te beje padi ne gjyq.

KREU V E DREJTA E DISPONIMIT TE DOKUMENTEVE DHE E INFORMACIONIT

Neni 17

I gjithë dokumentacioni, qe Kontrolli i Larte i Shtetit e gjykon te nevojshem per kryerjen e detyrave te tij, duhet t'u sigurohet dhe t'u paraqitet nga subjektet e kontrolluara perfaqesuesve te autorizuar te Kontrollit te Larte te Shtetit.

Kur eshte e nevojshme, Kontrolli i Larte i Shtetit ka te drejte:

a/te pyese me shkrim ose verbalisht subjektet e kontrolluara ose punonjesit e tyre, te cilet jane te detyruar t'i pergjigjen me shkrim ose verbalisht sipas kerkeses se Kontrollit te Larte te Shtetit, brenda nje jave nga kerkesa e bere;

b/te kerkoje nga subjektet e kontrolluara t'i sigurohen menjehere ambientet dhe paisjet e punes ne perputhje me kete ligj ;

c/te kerkoje nga subjektet e kontrolluara ne nenin 6 te ketij ligji t'i vihet ne dispozicion brenda nje jave gjithë dokumentacioni per vlerat materiale e financiare, si dhe dokumentacioni per veprimtarine ekonomike dhe financiare;

d/te kerkoje nga Banka e Shqiperise, bankat e nivelit te dyte e bankat e tjera te perbashketa, t'i vihen ne dispozicion brenda nje jave te dhenat per llogarite e subjekteve qe i neneshtrohen kontrollit ne baze te ketij ligji.

Gjate kontrollit, Kontrolli i Larte i Shtetit, sipas nenit 6 paragrafi 2, dergon raportin e kontrollit te subjektet e kontrolluara. Keta te fundit jane te detyruar te japin shpegimet e tyre brenda nje muaji.

KREU VI RAPORTET E KONTROLLIT

Neni 18

1. Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit :

a/ raportin per zbatimin e buxhetit faktik te shtetit, duke perfshire konkluzionet e kontrollit me opinionin e vet.

Raporti vjetor paraqitet ne Kuvend ne perputhje ne ligjin 8379 date 29.7.1998 “Per hartimin dhe zbatimin e Buxhetit te Shtetit te Republikes se Shqiperise”.

Raporti vjetor publikohet ne buletin.

b/ mendime per raportin e Keshillit te Ministrave per shpenzimet e vitit te kaluar financiar, para se te miratohet ne Kuvend;

c/ informacion per rezultatet e kontrollit, sa here qe kerkoet nga Kuvendi.

Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor te veprimtarise se tij brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes.

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit, mund ti kerkoje Kuvendit qe te degjohet per ceshtje qe ai i çmon te rendesishme.

Neni 19

Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit mund te ftohet te marre pjese dhe te flase ne mbledhjet e Keshillit te Ministrave kur shtrohen ceshtje qe lidhen me funksionet e tij.

Kontrolli i Larte i Shtetit duhet t'i paraqese Keshillit te Ministrave dhe autoriteteve te tjera, kur ajo e gjykon te nevojshme dhe ne interes te shtetit dhe te publikut, raporte, studime dhe materiale te tjera qe kane te bejne me Keshillin e Ministrave, ministrite dhe institucionet qendrore.

KREU VII

STATUSI I PERSONELIT DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 20

Punonjesit e Kontrollit te Larte te Shtetit nuk duhet te bejne pjese ne asnje organizate ose parti politike, si edhe nuk duhet te marrin pjese ne veprimtari politike ose me karakter tregtar.

Punonjesit e Kontrollit te Larte te Shtetit duhet te permbushin detyrat e tyre ne menyre profesionale ne perputhje me standartet e kontrollit dhe normat etike.

Administrimi i sherbimit civil ne Kontrollin e Larte te Shtetit, ngritja ne detyre, levizja paralele, vleresimi, transferimi, lirimi pezullimi si dhe masat disiplinore, behen ne perputhje me ligjin Nr. 8549 date 11.11.1999 “Statusi i nepunesit civil”.

KREU VIII

RUAJTJA E SEKRETTIT

Neni 21

Kontrolli i Larte i Shtetit duhet t'i kushtoje kujdesin e duhur sekretit shteteror e tregtar.

Kontrolloret e Kontrollit te Larte te Shtetit pajisen me karten e identifikimit personal te leshuar nga Kryetari i saj.

Standartet e kontrollit te nxjerra nga Kontrolli i Larte i Shtetit jane te detyrueshme per t'u zbatuar edhe nga organet e kontroll-revizionit te brendshem (shteteror).

Neni 22

Veprimtarite qe perbejne sekret shteteror bazuar ne dispozitat perkatese ligjore, duhet te kontrollohen nga kontrolloret e autorizuar nga Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit dhe raportimi i zbulimeve te kontrollit duhet te behet prej tij ne Komisionin e Perhershem te Ekonomise, Financave dhe Privatizimit te Kuvendit.

KREU IX

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 23

Ligji Nr.7597 date 31.8.1992 "Per Sherbimin e Kontrollit te Shtetit", ndryshuar me ligjin Nr.7949, date 14.6.1995 dhe me ligjin Nr.8236, date 28.8.1997, si dhe çdo dispozite tjeter qe bie ne kundërshtim me kete ligj, shfuqizohen.

Ligji Nr.7802, date 2.3.1994 "Per pagat e Kryetarit dhe zevendes kryetarit te Sherbimit te Kontrollit te Shtetit", ndryshuar me ligjin Nr.8037, date 22.11.1995, shfuqizohet.

Neni 24

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare .

KRYETARI I KUVENDIT

Skender Gjinushi

Shpallur me dekretin Nr.2647 date 8.06.2000 te Presidentit te Republikes, Rexhep Meidani.

LIGJI NR. 8417 DATE 21.10.1998
KUSHTETUTA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PJESA E KATERMBEDHJETE

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Neni 162

1. Kontrolli i Larte i Shtetit eshte institucioni me i larte i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nenshtrohet vetem Kushtetutes dhe ligjeve.
2. Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim te Presidentit te Republikes. Ai qendron ne detyre per 7 vjet, me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 163

Kontrolli i Larte i Shtetit kontrollo:

- a) veprimtarine ekonomike te institucioneve shteterore e te personave te tjere juridike shteterore;
- b) perdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shteterore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;
- c) veprimtarine ekonomike te personave juridike, ne te cilet shteti ka me shume se gjysmen e pjeseve ose te aksioneve, ose kur huat, kredite dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164

1. Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit :
 - a) raport per zbatimin e buxhetit te shtetit ;
 - b) mendim per raportin e Keshillit te Ministrave per shpenzimet e vitit te kaluar financiar para se te miratohet nga Kuvendi;
 - c) informacion per rezultatet e kontroleve sa here qe kerkohet nga Kuvendi.
2. Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor te veprimtarise se tij.

Neni 165

1. Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit mund te ftohet te marre pjese dhe te flase ne mbledhjet e Keshillit te Ministrave , kur shqyrtohen çeshtje qe lidhen me funksionet e tij.
2. Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit te Gjykates se Larte.

Neni 183

Kjo Kushtetute hyn ne fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikes.

Miratuar me referndum me 22.11.1998

Shpallur me dekretin nr.2260, date 28.11.1998 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani.

(botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.28 te vitit 1998)